



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES



AGJENCIA E AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE

Adresa e Kontaktit:

Agjencia e Akreditimit të Arsimit të Lartë  
Rruga "Lekë Dukagjini", Nr.5  
Tiranë

Tel/Fax: +355 4 257 954

Tel/Fax: +355 4 266 302

E-mail: [aahe\\_aaal@adanet.com.al](mailto:aahe_aaal@adanet.com.al)

Website: [www.aaal.edu.al](http://www.aaal.edu.al)

---

# Udhëzues për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë

---



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES



AGJENCIA E AKREDITIMIT TE ARSIMIT TE LARTE

---

## Udhëzues për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë

---

*përgatitur nga :*

Prof.As. Dhurata Bozo  
Prof. Adem Tamo  
Prof.As. Mimoza Hafizi

Shtator 2005

## HYRJE

Zhvillimet shoqërore në tërësi në vendin tonë dhe ato në fushën e Arsimit të Lartë në veçanti, politika e integritit të vendit në Komunitetin Europian dhe në këtë kuadër edhe përfshirja e arsimit tonë të lartë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë, dëshira dhe përpjekjet e arsimit të lartë për më shumë autonomi reale, përforcojnë dhe rrisin përgjegjësinë e institucioneve shtetërore dhe universitare që lidhen me Arsimin e Lartë.

Angazhimi zyrtar i politikës shqiptare për të pranuar e zbatuar dokumentet që lidhen me Procesin e Bolonjës, firmosja nga qeveria shqiptare e dokumentit angazhues për t'u përfshirë në këtë proces në Konferencën e Berlinit në shtator 2003, shtron, përveç të tjerave, nevojën e zhvillimit të kulturës së cilësisë dhe të procedurave që lidhen me vlerësimin e saj në mjediset universitare. Në takimin e fundit të Ministrave të Arsimit në Bergen në maj 2005, Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë riformulohet si një nga shtyllat kryesore të reformës në kuadrin e Procesit të Bolonjës që sigurohet përmes institucioneve kombëtare të Sigurimit të Cilësisë në bashkëpunimin të ngushtë me Institucionet e Arsimit të Lartë dhe institucionet përkatëse europiane e më gjerë.

Cilësia në Arsimin e Lartë është një koncept shumëdimensional. Ajo ka të bëjë me të gjitha

funksionet dhe aktivitetet që kryhen në institucionet e arsimit të lartë: me mësimdhënien dhe të nxënit, me kërkimin shkencor, me pranimet e studentëve, punësimin e kualifikimin e pedagogëve, me ndërtesat dhe pajisjet, me shërbimet për të tretët dhe me drejtimin. Vlerësimi i gjithë këtyre dimensioneve e ka të nevojshëm si këndvështrimin e atyre që janë brenda tij dhe pjesë përbërëse, ashtu edhe e atyre që janë jashtë tij dhe që kanë eksperiencën e duhur për të vlerësuar cilësinë. Kësisoj kombinimi i vlerësimit të brendshëm me vlerësimin e jashtëm të Institucionit të Arsimit të Lartë (IAL) është jetik për rritjen e cilësisë.

Vlerësimi i Cilësisë dhe Akreditimi janë dy komponentët e Sigurimit të Cilësisë. Vlerësimi i Cilësisë kryhet përmes Vlerësimit të Brendshëm (Vetëvlerësimit) dhe Vlerësimit të Jashtëm. Ndërsa vlerësimi është procesi real i evidentimit të nivelit të cilësisë në një IAL, kurrikul apo program akademik, akreditimi është procesi i vendimmarrjes në lidhje me vlerësimin e kryer.

Procesi i vlerësimit të brendshëm është tregues i rëndësishëm i autonomisë së IAL. Ndërkohë, ai përbën një ndihmesë për ekipet drejtuese dhe ekzekutuese të njësive të shkollës së lartë në drejtim të ndërgjegjësimit me problematikën, si dhe lehtëson vendosjen e një klime besimi reciprok mes stafeve akademike, ndihmëse e drejtuese dhe studentëve e publikut të gjerë, të cilët marrin pjesë në këtë proces.

Nga ana tjetër, është e qartë se në kushtet kur kërkohet më shumë autonomi dhe përgjegjshmëri për

IAL, vlerësimi me ekspertë të jashtëm bëhet i domosdoshëm për të provuar vlefshmërinë dhe objektivitetin e vlerësimit të brendshëm; pra është vlerësimi i jashtëm ai që provon në fund të fundit cilësinë e një institucioni, të një kurrikule apo të një diplome.

Qëllimi është që shoqëria të marrë në mënyrë të qartë, të vërtetë, transparente dhe të përdorshme për publikun informacione të sakta për gjendjen e Arsimit të Lartë. Të interesuarit për njohjen e gjendjes janë të shumtë: shoqëria, prindërit, studentët, punëdhënësit, politika etj. Prandaj dhënia e informacioneve për gjendjen dhe analiza e saj nga njëra anë, u jep atyre mundësinë për të bërë zgjedhjen e dëshiruar në tregun e Arsimit të Lartë, dhe nga ana tjetër është një provë se Institucioni i Arsimit të Lartë e pranon përgjegjësinë që pretendon se ka marrë apo që dëshiron të marrë, rrit shkallën e besimit të partnerëve socialë dhe të përdoruesve të tij.

Sigurimi i Cilësisë nga jashtë shërben për të ruajtur Standardet Kombëtare të Cilësisë në Arsimin e Lartë, për akreditimin e programeve dhe/ose institucioneve të Arsimit të Lartë, për mbrojtjen e përdoruesve të këtij shërbimi, për dhënien e një informacioni të pavarur me të dhëna sasiore dhe cilësore për programet apo institucionet drejt synimit afatgjatë për sigurimin dhe rritjen e cilësisë në këtë sektor të edukimit publik.

Në këtë kuadër, për Agjencinë e Akreditimit të Arsimit të Lartë, hartimi i Udhëzuesve të Vlerësimit, i Manualeve sipas Standardeve bashkëkohore të Cilësisë dhe përpilimi i procedurave të qarta e transparente për

vlerësimin e saj në të gjitha nivelet e organizimit universitar dhe në të gjitha sferat e veprimtarisë së tij, është një përgjigje ndaj detyrës së saj funksionale si pjesë e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë dhe Akreditimit. Kërkesa gjithnjë në rritje ndaj shkollës së lartë drejt standardeve europiane, si në lëmin e arsimimit ashtu edhe në atë të kërkimit shkencor, e bën këtë detyrim akoma më imperativ e themelor.

Për këtë arsye Agjencia propozon Udhëzuesin për Vlerësimin e Jashtëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Ky material vijon botimin më parë të Udhëzuesit për Vetëvlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Synimi kryesor i këtij materiali është që të udhëzojë e ndihmojë Grupet e Vlerësimit të Jashtëm gjatë një procesi të plotë vlerësimi e akreditimi; të ndihmojë IAL të jenë bashkëpunuese me Grupet e Vlerësimit të Jashtëm dhe të përfitojnë nga eksperiencia e tij, të ndihmojë IAL të ndërtojnë procedurat dhe praktikat për vlerësimin e cilësisë për ta bërë këtë proces pjesë të pandashme të gjithë punës së tyre në institucion. Reformimi i vazhdueshëm i arsimit që bazohet në nevojat e tij të brendshme, por edhe proceset integruese e kërkojnë krijimin e një kulture cilësie, në kuptimin që të mundësojë jo vetëm planifikime objektive, por edhe shkëmbimin e informacionit, të pedagogëve dhe të studentëve, kryerjen e projekteve të përbashkëta me institucionet e ngjashme të vendeve të BE dhe më gjerë.

Pra në analizë të fundit, Vlerësimi i Jashtëm ndihmon në mënyrë të tërthortë ngritjen e Sistemeve të

Brendshme të Sigurimit të Cilësisë në IAL, që çon drejt krijimit të kulturës së cilësisë, që është në fund të fundit edhe qëllimi i institucioneve të jashtme të Sigurimit të Cilësisë (AAAL, Këshilli i Akreditimit dhe MASH).

Ky udhëzues hartohet për herë të parë për sistemin e arsimit të lartë tek ne. Për hartimin dhe përgatitjen e tij janë shfrytëzuar të gjitha dokumentat europiane në mbështetje të procesit të Bolonjës, përvoja e agjencive homologe europiane, standardet që u miratuan për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë në Bergen në maj 2005 dhe përvoja pakvjeçare e AAAL për t’ia përshtatur këtë udhëzues edhe situatës dhe kushteve tona. Megjithatë ky udhëzues sikurse të gjitha dokumentet në mbështetje të Sigurimit të Cilësisë janë në ndryshim të vazhdueshëm, pasi i tillë është edhe vetë procesi i reformimit të arsimit të lartë në kuadrin e procesit të zbatimit të dokumentave të Bolonjës.

### **Autorët**

## **P E R M B A J T J A:**

*Faqe*

<b>HYRJE</b> .....	<b>3</b>
<b>I. PROCESI I VLRESIMIT</b> .....	<b>9</b>
<b>II.VLRESIMI I JASHEM</b> .....	<b>14</b>
II.1. Etapat dhe kohëzgjatja.....	<b>13</b>
II.2. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm.....	<b>15</b>
II.3. Programi i punës i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.....	<b>19</b>
II.4. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.....	<b>25</b>
II.4. 1. Përshkrimi.....	<b>28</b>
II.4. 2. Analiza.....	<b>28</b>
II.4. 3. Sinteza.....	<b>32</b>
II.4. 4. Përfundime.....	<b>36</b>
II.4. 5. Rekomandime.....	<b>37</b>
<b>III.MARRREDHENIET E GRUPIT TE VLRESIMIT TE JASHEM</b>	
<b>ME IAL, GRUPIN E VLRESIMIT TE BRENDSEHEM</b>	
<b>DHE AAAL</b> .....	<b>40</b>
<b>IV. RAPORTI PERFUNDIMTAR I VLRESIMIT</b> .....	<b>42</b>
<b>V. AKREDITIMI</b> .....	<b>44</b>

## I. PROCESI I VLERESIMIT

Vlerësimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë kryhet nën drejtimin e Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë (AAAL). Ai mund të marrë në analizë diplomat e lëshuara nga një Institucion i Arsimit të Lartë (IAL), lëndët mësimore, kurset e studimit, të gjithë institucionin, apo sistemet e brendshme të cilësisë së IAL. Si i tillë ai është shumëllojsh. Të gjitha llojet e vlerësimeve që kryhen udhëhiqen si rregull nga parimi i kombinimit të ecures së kryer deri në momentin e vlerësimit me perspektivën. Duke qenë kështu, vlerësimi i cilësisë i ofron IAL instrumentin e vlerësimit objektiv të asaj që është arritur si dhe perspektivën e ndryshimeve që duhen bërë për sigurimin dhe rritjen e cilësisë.

Vlerësimi i cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.

Objektivat kryesorë të procesit të vlerësimit janë:

- Të zbulojë fakte që bëjnë sa më të qartë gjendjen e një institucioni, programi a kurrikule në

Arsimin e Lartë, në kohë reale dhe në kontekstin kombëtar e ndërkombëtar.

- Të nxisë kryerjen në mënyrë objektive dhe vullnetare të vetëvlerësimit, për të krijuar një tablo të qartë dhe transparente për njësinë, mbi bazën e së cilës njësia të ndërtojë politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj.

- Të bëjë publik informacionin, me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për cilësinë e IAL, programeve, kurrikulave, diplomave e shërbimeve që ato ofrojnë.

- Të japë një bazë të mjaftueshme të dhënash, rekomandimesh e konsideratash profesionale, që do të shërbejnë si pikënisje për procesin e mëtejshëm të akreditimit.

- Të thellojë kuptimin rreth nevojës për vlerësimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe të shërbejë për kultivimin e kulturës së cilësisë në IAL e cila shihet në ndërtimin e strukturave, praktikave dhe procedurave të brendshme të vlerësimit të cilësisë, struktura të cilat kombinojnë eksperiencën e fituar gjatë vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm.

- Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e kulturës së cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë, i cili është edhe objektivi më afatgjatë i gjithë këtij procesi.

Vlerësimi i Cilësisë kalon në dy faza: **Vlerësimi i Brendshëm** (Vetëvlerësimi) dhe **Vlerësimi i Jashtëm**.

**Vlerësimi i Brendshëm** (Vetëvlerësimi) është vlerësimi që kryhet nga vetë institucioni që kërkon të akreditohet ose të cilit i kërkohet përfshirja në procesin e akreditimit. Këtë vlerësim institucioni e kryen nën përgjegjësinë e vet si në rastin e iniciativës së nisur prej tij për akreditim, ashtu edhe në rastin kur atij i kërkohet përfshirja në procesin e akreditimit, në përshtatje me planet e akreditimit. Rezultatet e këtij vlerësimi pasqyrohen në **Raportin e Vlerësimit të Brendshëm** (RVB). Raporti i vetëvlerësimit është pjesë përbërëse e një pakete të plotë e cila quhet **Dosja e Vetëvlerësimit** (DVB). Dosja e Vetëvlerësimit përmban gjithë materialin dokumentar mbi të cilin mbështetet veprimtaria e institucionit që akreditohet. Materialet e kësaj dosjeje i vihen në dispozicion edhe ekipit të vlerësimit të jashtëm. Gjatë krijimit të dosjes së vetëvlerësimit bëhet kujdes që ajo të paraqesë zhvillimin e institucionit në historinë e tij, të paraqesë të gjitha vlerësimet e mëparshme të kryera në institucion, të evidentojë treguesit e arritjeve dhe të dobësive të institucionit, perspektivën drejt së cilës institucioni po shkon. Paraqitjen më analitike dhe më tërësore të kësaj ecurie e përmban raporti i vetëvlerësimit. Hartimi i këtij raporti bëhen në përputhje me rekomandimet e paraqitura në Udhëzuesin për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë (botim i AAAL, prill 2005).

**Vlerësimi i Jashtëm** kryhet nga Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm (GVJ) i cili formohet, udhëzohet dhe ndjek kriteret e paracaktuara nga AAAL dhe Këshilli i Akreditimit (KA) dhe të përkrahura në këtë udhëzues. Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) kërkohet dhe mbështetet nga AAAL. Përmbajtja e tij është në përgjegjësinë e GVJ dhe në këtë kuptim ky vlerësim është i pavarur, ndërkohë që raporti është në pronësi të AAAL. Për pasojë anëtarët e GVJ nuk kanë të drejtë të nxjerrin të dhëna, të bëjnë publike apo të botojnë pjesë të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm pa lejen e AAAL. Periudha e caktuar për kryerjen e vlerësimit të jashtëm ndahet në një fazë faktmbledhëse dhe në një fazë analizuese. Këto faza kurorëzohen me hartimin e raportit vlerësues për të gjithë përbërësit e përcaktuar në udhëzimin që vijon.

Pas përfundimit të dy raporteve (RVB dhe RVJ), AAAL përgatit **Raportin Përfundimtar të Vlerësimit** (RPV) duke u mbështetur në tre burime kryesore:

- Dosjen e Vetëvlerësimit, përfshirë Raportin e Vetëvlerësimit (RVB);
- Raportin e Vlerësimit të Jashtëm (RVJ);
- Procesverbalet dhe diskutimet e organizuara nga AAAL si gjatë vetëvlerësimit ashtu dhe gjatë vlerësimit të jashtëm.

Me përfundimin e Vlerësimit të Jashtëm, Raporti Përfundimtar i Vlerësimit i paraqitet Këshillit të Akreditimit (KA) për të dhënë rekomandimet apo propozuar vendimet përkatëse. Në bazë të vendimit që

merret për çdo vlerësim, raporti i vlerësimit apo rezultatet e vlerësimit bëhen **publike**.

Hollësi të mëtejshme për procedurën e plotë të vlerësimit dhe akreditimit në Arsimin e Lartë mund të gjeni në materialin e AAAL “**Procedura për Vlerësimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë**”, miratuar nga Këshilli i Akreditimit në Qershor 2004.

## II. VLERESIMI I JASHEM

Vlerësimi i Cilësisë dhe Akreditimi kërkohen nga vetë Institucioni i Arsimit të Lartë ose nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në rastin kur vlerësimi kërkohet nga IAL, ai fillon vetëm pasi miratohet nga KA dhe kryhet sipas afateve kohore të përcaktuara nga AAAL dhe të miratuara nga KA. Një proces i plotë vlerësimi me qëllim akreditimi zgjat nga 2 muaj në 2 vjet dhe kohëzgjatja e saktë përcaktohet në varësi të madhësisë së institucionit që akreditohet dhe të faktit nëse vlerësimi është në nivel programesh, institucioni apo miks. Brenda kësaj kohe, faza e Vlerësimit të Jashtëm ze rreth gjysmën e kohës së vlerësimit. Në çdo rast konkret, afati kohor dhe kohëzgjatja e një vlerësimi përcaktohen nga AAAL e më pas miratohen nga KA.

### II.1. Etapat dhe kohëzgjatja

Vlerësimi i Jashtëm përbëhet nga disa etapa:

- a) Përcaktimi i afateve kohore të Vlerësimit të Jashtëm
- b) Njoftimi i njësisë në vlerësim me afatet kohore të Vlerësimit të Jashtëm
- c) Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm
- d) Njoftimi i njësisë me përbërjen e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm



- e) Kontraktimi i anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ)
- f) Trainimi i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm nga stafi i AAAL
- g) Njohja e GVJ me Dosjen e Vetëvlerësimit dhe diskutimi i saj
- h) Hartimi nga grupi i Programit të Punës
- i) Përgatitja e GVJ për vizitat në IAL
- j) Takimi i GVJ me titullarin e njësisë në vlerësim dhe Grupin e Vetëvlerësimit
- k) Vizita në vend e GVJ
- l) Hartimi nga GVJ i Raportit paraprak të Vlerësimit të Jashtëm
- m) Diskutimi i raportit paraprak me përfaqësues të njësisë së vlerësuar
- n) Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Jashtëm dhe dorëzimi i tij në AAAL

Përveç kriterëve të mësipërme, anëtari i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm pritet t'u përmbahet disa kërkesave me karakter etik të cilat në tërësinë e tyre mundësojnë që produkti i punës së tij të ketë dobi për shoqërinë, të jetë në përputhje me interesat e zhvillimit të arsimit të lartë dhe të respektojë pjesëmarrësit në të. Ekspertëve nuk u lejohet fshehja e të dhënave, sajimi ose ndryshimi i tyre, injorimi i ndjeshmërisë së pjesëmarrësve, plagjiatura, braktisja e së vërtetës për interesa të caktuara etj. Në përshtatje me këto parime kryesore është e natyrshme që anëtari i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të

informojë pjesëmarrësit për natyrën e studimit që ai kryen; të kryejë vlerësimin paraprak e të kujdesshëm të pranueshmërisë së veprimeve të tij; të përcaktojë shkallën e dëmtimit të mundshëm prej tij të të tjerëve; t'ua bëjë të ditura detyrimet dhe përgjegjësitë e tij edhe subjekteve edhe studiuesve të tjerë; të respektojë lirinë e pjesëmarrësve për ta ndërprerë bashkëpunimin me të; të mbrojë pjesëmarrësit në studim nga çdo lloj dëmtimi që lidhet me procedurat e studimit; të konsiderojë konfidencial çdo informacion të studimit deri në momentin që për të merret një vendim tjetër, etj. Respektimi i këtyre kërkesave mundëson vlerësime të jashtme objektive, të dobishme dhe të pranueshme.

Gjatë gjithë procesit, AAAL kujdeset që të respektohen kriteret dhe kërkesat e përcaktuara, të ndiqet në mënyrë të saktë procedura në fjalë dhe udhëzimet e përfshira në këtë udhëzues, mbështet GVJ për nevojat që ka në punën e tij dhe informohet për ecurinë e punës. Në raste mosrespektimi, AAAL diskuton, vendos ose jep rekomandimet përkatëse për GVJ.

## II.2. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Në përzgjedhjen e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbahen parasysh njohja e programit dhe/ose karakterit të IAL që vlerësohet, njohja e institucioneve të larta akademike, aftësitë dhe integriteti profesional, paanshmëria, objektiviteti, përfaqësimi në grup i sa më shumë opinioneve duke u përpjekur për të shmangur

në maksimum përfshirjen në të të personave konfliktualë ose koniukturalë. Anëtarët e GVJ janë të pavarur në punën e tyre, dhe udhëhiqen nga shërbimi në dobi të përmirësimit të cilësisë në institucionin përkatës. Ata qëndrojnë mes grupeve me interesa të ndryshme si vlerësues të paanshëm e objektivë të ecurive. Këto kritere pasqyrohen në përmbajtjen e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, në varësi nga vëllimi i punës dhe specifika e çdo vlerësimi, si rregull ka në përbërje të tij 3-5 persona nga të cilët 2-3 duhet të jenë ekspertë të fushës, 1 përfaqësues i AAAL dhe mundësisht 1 student.

Anëtarët e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm përzgjidhen nga AAAL dhe miratohen nga KA në bazë të kritereve të mëposhtme:

- a) Të jenë figura të mirënjohura në fushën që mbulon vlerësimi dhe të kenë njohje e vizion të gjerë për programet mësimore. Është mirë që një nga antarët e grupit të ketë njohuri apo përvojë mbi funksionimin e IAL dhe politikën e arsimit të lartë në vend
- b) Të kenë grada ose tituj akademikë; këtu mund të bëhet përjashtim vetëm në ato raste kur një anëtar i grupit zgjidhet nga tregu i punës dhe nuk gjenden nga ky sektor me titull ose gradë
- c) Të mos kenë asnjë lloj konflikti interesash me njësinë që vlerësohet: antarët e grupit nuk mund të jenë punonjës të njësisë që vlerësohet.

- d) Të paktën një nga antarët e grupit duhet të vijë nga mjedisi joakademik si tregu i punës apo institucione kërkimore-shkencore jouniversitare
- e) Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandohet që të ketë në përbërje një student përfaqësues të organizatave studentore. Në ato raste kur kjo nuk është e mundur, duhet patjetër të përfshihen në proces mendimet, opinionet dhe sugjerimet e studentëve të kursit apo njësisë që vlerësohet
- f) Preferohet që si anëtarë të grupit të vijnë dhe ekspertë të huaj që përmbushin kriteret e mësipërme

Grupi ngrihet qëllimisht për misionin e vlerësimit (grup *ad hoc*) dhe shpërndahet pas përfundimit të vlerësimit dhe dorëzimit të raportit. Ai përcakton një strukturë organizative: zgjedh në mënyrë konsensuale një kryetar, një sekretar dhe harton një Program Pune.

Kryetari i Grupit ka për detyrë të drejtojë e koordinojë punën e grupit, ndan detyrat brenda grupit, përcakton afatet kohore për përmbushjen e tyre, mban përgjegjësinë kryesore për mbarëvajtjen e punës, për respektimin e udhëzuesit të vlerësimit, marrëdhëniet brenda grupit dhe marrëdhëniet e këtij të fundit me IAL dhe AAAL.

Përfaqësuesi i AAAL në GVJ ka për detyrë të monitorojë të gjithë procesin, të ndihmojë anëtarët e grupit në të gjitha fazat e punës dhe të sjellë në AAAL problemet që mund të hasen. Përfaqësuesi i AAAL kujdeset gjithashtu në sigurimin e të dhënave të

nevojshme, të dokumentacionit ligjor e joligjor të IAL si dhe ndërmjetëson realizimin e Programit të Punës të GVJ. Por AAAL nuk mund të ndërhyjë e të ndikojë mbi anëtarët e grupit në kryerjen e punës së tyre, sidomos në aspektin ngushtësisht profesional. AAAL nuk duhet gjithashtu të ndikojë në mendimet dhe opinionet e antarëve të grupit të shprehura në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

Pas ngritjes së GVJ, AAAL i bën të njohur IAL që do vlerësohet, përbërjen e grupit dhe pret komentet apo ankesat e tij për ndonjë nga anëtarët. Në ato raste kur IAL ka ankesa, AAAL i shqyrton ato dhe mban qendrimet që i konsideron të arsyeshme. Pas kësaj faze, përbërja përfundimtare e GVJ kalon për miratim në KA. Pas miratimit, AAAL i bën të njohur IAL përbërjen e GVJ, duke i kërkuar njësisë caktimin e një koordinatori për lehtësimin e realizimit të Programit të Punës.

Menjëherë pas ngritjes dhe miratimit të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, AAAL lidh kontratën e bashkëpunimit me secilin nga antarët e grupit, me përjashtim të përfaqësuesit të saj. Në këtë kontratë përfshihen Detyrat dhe të Drejtat e palëve, Përshkrimi i Punës, afatet kohore, shpërblimi sipas legjislacionit në fuqi dhe kushtet e zgjidhjes së kontratës.

### II.3. Programi i Punës i GVJ

Në fillim të procesit të Vlerësimit të Jashtëm, GVJ trainohet nga specialistë të AAAL për të gjithë

procedurën e vlerësimit. GVJ pajiset me Dosjen e Vetëvlerësimit që përfshin Raportin e Vetëvlerësimit (shih Udhëzuesin për Vlerësimin e Brendshëm të Cilësisë në Arsimin e Lartë, botim i AAAL, 2004), me Procedurën e Vlerësimit dhe Udhëzuesin e Vlerësimit të Jashtëm. Gjatë këtij takimi GVJ në bashkëpunim me AAAL harton Programin e Punës, zgjedh kryetarin dhe sekretarin e GVJ dhe bën ndarjen e detyrave midis antarëve. Në këtë takim firmosen gjithashtu kontratat e bashkëpunimit të AAAL me secilin nga anëtarët e GVJ.

Në Programin e Punës së GVJ duhet të parashikohen detyrimisht:

- a) Diskutimi paraprakisht në grup i Raportit të Vetëvlerësimit
- b) Takimi i GVJ me titullarin e njësisë dhe Grupin e Vetëvlerësimit. Ky takim ndërmjetësohet nga AAAL
- c) Vizita e GVJ në IAL dhe njohja e IAL me axhendën e vizitave të GVJ
- d) Kuadri dhe aspektet e vlerësimit dhe njohja e IAL me to
- e) Instrumentet që do të përdoren për intervistim e anketim
- f) Lista e personave që do të intervistohen nga GVJ
- g) Mjediset dhe aktivitetet që do vizitohen dhe njohja e IAL me to

- h)** Aspektet kryesore që do të trajtohen në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm
- i)** Afatet kohore të përgatitjes së draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm
- j)** Diskutimi i Raportit paraprak të Jashtëm me personelin drejtues të institucionit, përfaqësues të grupit të vetëvlerësimit, të studentëve dhe të administratës, të këshillit të faktultetit, senatit të institucionit që kërkon të akreditohet
- k)** Reflektimi i komenteve e sugjerimeve të IAL në një seksion të posaçëm të raportit
- l)** Paraqitja në AAAL e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm

Gjatë diskutimit paraprak të Raportit të Vetëvlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm duhet të shqyrtojë me kujdes çështje të tilla si:

- a)** A është sjellë në dosje i gjithë dokumentacioni i kërkuar që dëshmon bazën ligjore, mënyrën e funksionimit, menaxhimin, strukturën organizative, statusin, diplomat e lëshuara etj.?
- b)** A janë sjellë të gjitha të dhënat sasiore dhe cilësore të mjaftueshme për të krijuar një ide fillestare mbi stafin, programet, infrastrukturën, studentët, etj.?
- c)** A jepet në mënyrë të qartë gjendja e diplomës, programit, të njësisë që është vlerësuar?

Pas kësaj analize, GVJ harton paraprakisht një skedë pyetjesh e pikash diskutimi, të cilat do trajtohen në takimin e parë që GVJ zhvillon me titullarin e institucionit dhe GVB.

Gjatë këtij takimi që ndërmjetësohet dhe njoftohet zyrtarisht nga AAAL, shkëmbehen opinionet midis grupeve të vlerësimit dhe GVJ sqaron paqartësitë, merr përgjigje për pyetjet që ka dhe kërkon dokumentacionin që mungon. Një nga antarët e GVJ caktohet si person kontakti midis GVJ dhe institucionit që vlerësohet. Ky kontakt do të shërbejë për të gjithë fazën kur GVJ viziton njësinë që vlerësohet. Ky person kontakti mund të jetë edhe përfaqësuesi i AAAL në GVJ. Gjatë këtij takimi, GVJ në bashkëpunim dhe marrëveshje me IAL përcakton një axhendë të saktë të ditëve të vizitës në vend dhe të grupeve të takimit (me stafin, personelin administrativ, studentë), vizitës në sekretarinë mësimore, në administratë, në mjediset mësimore, bibliotekë etj. Gjatë çdo takimi, sekretari mban një procesverbal me të dhënat e secilit më pas do shërbejnë për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm.

Pas përcaktimit të axhendës GVJ, sipas ndarjes së detyrave fillon ekspertizën në vend. Njësia që vlerësohet duhet të verë në dispozicion të grupit programet dhe planet mësimore, planet e zhvillimit, teste apo fletore provimesh, tekste, botime të stafit, CV të stafit, procedurat e vlerësimit të studentëve, rregullore të funksionimit të njësisë, e rekrutimit të stafit në shkallët e ndryshme të kualifikimit, e studentëve etj. Çdo anëtar i

IAL që vlerësohet duhet të ndodhet në vend gjatë kohës së vizitës së GVJ. Ekspertët mund të vizitojnë çdo mjedis të IAL, mund të kërkojnë informacion apo dokumentacion shtesë nëse e konsiderojnë të arsyeshme, mund të bëjnë takime me grupe pedagogësh, me pedagogë veçantë e anëtarë të tjerë të stafit mësimor, ndihmës-mësimor e administrativ dhe të intervistojnë këdo për të mbledhur informacionin që i nevojitet. Për këtë qëllim drejtuesit e IAL kanë përgjegjësinë të krijojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme për vizita, intervista e anketime sipas standardeve që njihen.

GVJ bën intervista të lira edhe me studentët, në mënyrë që të jetë në gjendje të krahasojë pikpamjet e opinionet e tyre me ato të stafit. Intervistat me studentët janë të rëndësishme, sepse prej tyre merret informacion mbi mënyrën si zhvillohet mësimi, mbi ngarkesën e tyre, cilësitë mësimdhënëse të stafit, format e mësimdhënies në praktikë, etj. Si material bazë për tërheqjen e mendimit të studentëve shërben Pyetësi i Studentit, hartuar nga AAAL në bashkëpunim me pedagogë të universitetit dhe studentë. Marrja e mendimeve të studentëve mund të bëhet edhe me anë të pyetësorëve të tjerë, duke përzgjedhur në të dy rastet në mënyrë të rastësishme grupe studentësh nga vite të ndryshme, të niveleve të ndryshme por jo ata që mund të jenë caktuar paraprakisht nga stafi i IAL. Në çdo rast, pyetësorët duhet të jenë anonimë dhe grupet e intervistuar duhet të jenë

sa më të mëdha për të përfaqësuar në mënyrë sa më besnike mendimin e përgjithshëm të studentëve.

Pjesë e programit të vizitës është edhe shqyrtimi i faciliteteve: mjediset mësimore, sallat e leksioneve, labororet, bibliotekat, mjediset ndihmëse apo argëtuese për studentët etj. Ekspertët, sipas fushës që mbulojnë, nëse e shohin të arsyeshme, mund të ndjekin edhe aktivitete mësimore, të shoqëruar nga përfaqësues të IAL.

GVJ kërkohet të takojë e diskutojë edhe me njësi të tjera jashtë IAL (fakultet, universitet, institut, akademi, shkollë e lartë) që lidhen me IAL që vlerësohet. Kështu nëse vlerësohet një fakultet mjekësie, atëherë jashtë tij mund të merret informacion edhe nga: politikëbërës të fushës së shëndetit, punëdhënës publikë e privatë, përfitues të shërbimeve mjekësore etj. Kështu nëse vlerësohet mësuesia atëherë informacion jashtë IAL për atë që ndodh në mësuesi mund të merret nga drejtoritë arsimore, nga shkolla publike e private, nga prindër, nga mësues të diplomuar vitet e fundit, nga studiues të fushës përkatëse etj.

Gjatë vizitës në IAL, GVJ duhet të vizitojë, të marrë informacion, të krijojë njohje e opinion e të shqyrtojë në IAL të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me aspektet e vlerësimit, që trajtohen më poshtë.

Vizita e GVJ në IAL që vlerësohet zgjat nga 1 në 8 javë, në varësi të madhësisë së njësisë, numrit të diplomave e programeve që vlerësohen, largësisë

gjeografike nga vendqendrimi i GVJ, vështirësive organizative e operacionale etj.

Në përfundim të vizitës në vend, GVJ konkludon mbi gjetjet e misionit të tij dhe i klasifikon ato në përshtatje me strukturën e njohur të vlerësimit. Në kuptimin e këtij raporti, *gjetje* konsiderohen faktet dhe qëndrimet që konstatohen në IAL dhe që kanë të bëjnë me vlerësimin e cilësisë në të. Në përfundim të kësaj GVJ në bashkëpunim me IAL organizon një Takim Diskutimi ku GVJ prezanton të gjitha gjetjet kryesore të misionit të tij para një audience të përbërë nga drejtues të IAL, nga administrata, trupa pedagogjike, trupa studentore, biznesi etj, dhe merr reagimet e tyre lidhur me saktësinë e gjetjeve. Qëllimi i këtij takimi është kryesisht verifikimi i gjetjeve dhe, nëse është e mundur, edhe pasurimi i tyre. Nëse ka gjetje që kundërshtohen, për to organizohet diskutim dhe të gjitha kundërshtimet e paraqitura në takim përmbledhen në një seksion të veçantë të raportit.

Metodologjia që përdoret në kryerjen e vlerësimit të jashtëm të IAL kërkon përdorimin e një numri të njohur metodash si studimi i materialit dokumentar që përshkruan ecuritë, problematikat, bazën ligjore e nënligjore mbi të cilën operon IAL si edhe programet etj.; kryerja e vëzhgimeve të drejtpërdrejta në mjediset dhe në aktivitetet që kryhen në IAL dhe të cilat mendohen si të rëndësishme për vlerësimin e cilësisë akademike të tij; kryerjen e intervistimeve me persona kyç për proceset akademike në IAL; organizimin e

fokusgrupeve me grupe të ndryshme interesi në IAL; anketimin e kategorive të caktuara të aktorëve në IAL.

Vizita në IAL mbyllet me një takim përfundimtar të GVJ me titullarin e institucionit dhe GVB ku kryetari shfaq përpara tyre opinionet e përgjithshme të vizitës dhe pret komentet e sugjerimet e tyre.

Pas vizitës në vend, GVJ harton Raportin e Vlerësimit të Jashtëm.

#### II.4. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm

Për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, GVJ duhet të udhëhiqet nga parimi i pasqyrimin të gjendjes së IAL dhe/ose diplomës apo programit në mënyrë sa më reale, objektive dhe të paanshme. Raporti duhet të jetë i thjeshtë dhe i kuptueshëm, ndaj duhet kushtuar kujdes në strukturën, përmbajtjen, stilin dhe tonin e të shkruarit. Në çdo rast ai duhet të përmbajë patjetër komponentët e mëposhtëm:

- Përshkrimin
- Analizën
- Sintezën
- Përfundime
- Rekomandime

Raporti nuk duhet të sjellë të dhëna (ato sillen me detaje në RVB) por duhet të sjellë gjetje dhe të shprehë qëndrimin e GVJ për to, duke treguar nivelin e tyre si në raport me praktikën më të mirë në vend e standardet kombëtare (aty ku ka), ashtu dhe me

standardet rajonale, europiane e më gjerë. Faktet kanë natyrë më objektive dhe gjenden në dokumentacionet, në urdhërat, udhëzimet, praktikat, procedurat, treguesit dhe të cilat mund të verifikohen përmes misionesh të tjera si të mirëqena. Qëndrimet përfaqësojnë sjellje të caktuara të anëtarëve që marrin pjesë në proceset e IAL dhe që lidhen me aktorët e procesit dhe si të tilla kanë natyrë me prirje subjektive. Gjithsesi edhe faktet edhe qëndrimet që GVJ arrin të zbulojë në IAL janë njëlloj të domosdoshme për një vlerësim objektiv të ecurive akademike në IAL.

Gjetjet duhet të paraqiten me kujdes, me qëllim që të mund të mbrohen dhe të verifikohen në raste oponentash. Rekomandohet që të paktën për secilën nga gjetjet që vlerësohen si të rëndësishme të tregohet edhe burimi i saj.

Puna e anëtarëve të GVJ në ekip ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe në formën në të cilën paraqitet raporti. Mungesa e kulturës së punës në ekip bën që raporti të ketë karakter jounik e fragmentar dhe të përmbajë stile të ndryshme. Harmonizimi i stileve të ndryshme kapërcehet me redaktime serioze dhe përdorimin e stilit teknik-shkencor. Përveç kësaj, pritjet që raporti të përmbajë edhe elementë të tjerë strukturorë si: hyrjen, tryezën e lëndës, listën e shkurtimeve, tabela dhe figura, listën e personave të intervistuar dhe shtojcat, listën bibliografike. Paraqitja teknike e raportit dhe kërkesat etike për realizimin e tij janë po ato që zbatohen përgjithësisht në kërkimin shkencor empirik.

## KOMPONENTET E RAPORTIT

### II.4.1. Përshkrimi

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm duhet të fillojë me Programin e Punës dhe mënyrën e kohën si është realizuar ky program. Raporti duhet të vijojë me një informacion të përgjithshëm për IAL e vlerësuar, historikun e tij, statusin, bazën ligjore e nënligjore, strukturën organizative dhe diplomat që lëshon.

### II.4.2. Analiza

Pas kësaj pjese hyrëse, merret në analizë secili nga aspektet e vlerësimit, duke iu përmbajtur materialit të AAAL “Aspektet dhe Treguesit e Vlerësimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Janar 2005. Për këtë mund të shfrytëzohet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, kur ai konsiderohet i besueshëm nga vetë grupi, si dhe takimet, procesverbalet dhe shënimet e mbajtura nga antarët e grupit gjatë vizitës në vend. Në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm duhet të përfshihen detyrimisht edhe të dhënat, mendimet, komentet e sugjerimet e studentëve për të gjitha ato aspekte të cilësisë ku ata mund të ndihmojnë procesin e vlerësimit dhe të përmirësimit të cilësisë.

Aspektet më të përgjithshme mbi të cilat duhet të orientohet dhe përqendrohet analiza e GVJ për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm janë:

**a. Misioni dhe Objektivat e Institucionit të Arsimit të Lartë (IAL), të një programi, të një kurrikule etj.**

Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

**b. Struktura organizative e IAL, e njësive përbërëse dhe menaxhimi i tij**

Skema organizative, organizimi hierarkik, çështje të politikave në sferën e vendimmarrjes, cilësia e stafit mbështetës, përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, kontratat e punës dhe marrëdhëniet e tjera të punës, mbledhja dhe përdorimi i informacionit për personelin.

**c. Analiza e kurseve të studimit, diplomave MSc etj.**

Struktura didaktike e njësisë, pranimet, shpërndarja e studentëve në kurset dhe vitet e studimit, ecuria e studentëve dhe kalueshmëria, koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera.

**d. Programet e studimit, organizimi i kurrikulave, Procesi i Bolonjës dhe kreditet**

Qëllimet e programeve të studimit, përmbajtja e programeve, shpërndarja e ngarkesës midis njësive të ndryshme mësimore, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor, harmonizimi i kursit të studimit, literaturë dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, pra Procesi i Bolonjës me të gjithë elementët e tij përbërës.

**e. Stafi mësimdhënës dhe mbështetës**

Struktura e stafit mësimor dhe mbështetës në kurrikulën e çdo kursi studimi, raportet staf mësimor/staf ndihmës/student; nevojat për staf, shpërndarja e ngarkesës, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, shkalla e kualifikimit të stafit, kriteret të rekrutimit të stafit.

**f. Mësimdhënia**

Organizimi, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive, niveli i studentëve, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria dhe probleme të tjera që lidhen me të, të dhëna për shkollimin pasuniversitar: kriteret, cilësia, pranimet, diplomimet, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies.



### **g. Kërkimi shkencor**

Politika e kërkimit, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, lidhja e kërkimit me mësimdhënien, prania e kurseve master, pjesëmarrja institucionale apo individuale në to, rezultatet e kurseve master, vlerësime zyrtare të aktivitetit kërkimor individuale ose për njësinë.

### **h. Studentët dhe pasuniversitarët**

Procedurat e pranimit të studentëve dhe zbatimi i tyre, statistika, kontrolli i dijeve, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë, punësimi i të diplomuarve, informimi i studentëve.

### **i. Fasilitetet, burimet materiale, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

Mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, rezidencat e konviktet.

### **j. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

Burimet e financimit, të dhëna në vite, shpenzimet, kostoja e studentit, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

### **k. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

Institucionalizimi i sistemit të sigurimit të cilësisë, funksionimi i tij, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

### **l. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

Kontaktet me mjedisin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, mobiliteti i stafit në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

## **II.4.3. Sinteza**

Pasi është bërë analiza e gjetjeve më të rëndësishme në institucion/program, renditur sipas aspekteve të mësipërme, raporti i sintetizon rezultatet e vlerësimit në **tre rubrika** kryesore që lidhen me Politikën e Formimit, Politikën e Kërkimit Shkencor dhe Administrimin. Gjatë kësaj sinteze, raporti duhet të japë përgjigje për pyetjet që vijojnë sipas këtyre tre rubrikave.

### **A. Politika e Formimit**

#### **Cila është oferta e formimit ?**

Planet dhe programet janë në përputhje me

misionin dhe mjedisin; sistemi me kohë të pjesshme dhe formimi i vazhdueshëm janë pjesë e aktivitetit të njësisë; oferta është në përputhje me objektivat lokale, kombëtare apo ndërkombëtare; oferta është e dukshme dhe që mund të vlerësohet; diploma universitare krijon kushte për punësimin; diploma pasuniversitare mbështetet tek kërkimi shkencor i njësisë dhe tek kontaktet e saj me partnerët ekonomikë, socialë, industriale etj. jashtë njësisë; përgatitja që jep njësia e ndihmon studentin dhe e përgatit atë për t'u përfshirë në tregun e punës.

### **Si realizohet oferta e formimit?**

Formimi zhvillohet në kushte të mira; njësia kontrollon e vlerëson në mënyrë të pakontestueshme studentët; oferta e formimit vlerësohet rregullisht; njësia ka një politikë të përmirësimit të pedagogjisë së mësimdhënies; ajo u propozon studentëve një shërbim që i ndihmon ata të kenë sukses.

### **Studentët, nga hyrja në dalje**

Njësia ka një politikë pritjeje, informimi dhe orientimi për studentët; ajo kujdeset edhe për grupe të veçanta studentësh (sportistë, handikapë etj.); ajo nxit pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale; ajo ve në dispozicion të studentëve dokumente dhe informacione të ndryshme; ajo organizon për ta një ndihmë edhe jashtë planeve e programeve mësimore zyrtare; "tutorati" është element i punës së njësisë në ndihmë të studentëve; njësia ndihmon studentët të

punësohen ose të jenë në kontakt me mjedisin punëmarrës gjatë dhe mbas diplomimit.

## **B. Politika e Kërkimit Shkencor**

Njësia njeht forcat dhe dobësitë e saj në lëmin e kërkimit; ajo nxit evoluimin, dinamizmin e kërkimit duke qenë në linjat e kërkimit të kohës; përcakton vetë përparësitë në lëmin e kërkimit dhe i realizon këto përparësi, duke garantuar të ardhmen e kërkimit; ka një politikë të vlerësimit të kërkimit dhe kujdeset për zbatimin e saj; ka produktivitet të kërkimit.

## **C. Qeverisja e IAL në shërbim të misionit të saj**

### **Niveli i autonomisë**

GVJ duhet të verifikojë nëse njësia ka statute koherente, debati demokratik është i mundur, autonomia është reale, njësia ka projekte zhvillimi, njësia përgatit çdo vit një raport të aktivitetit mësimor e shkencor që bazohet në raportet individuale etj.

### **Organizimi i njësisë dhe i njësive përbërëse të saj**

GVJ duhet të analizojë organigramën e njësisë, strukturën e njësisë ne raport me misionin e saj; shpërndarjen e kompetencave brenda njësisë; debatin e brendshëm; nëse shërbimet e brendshme janë në funksion të njësisë dhe misionit të saj.

### **Partnerët e njësisë**

A e njih njësi mjedisin e saj dhe rreth saj, a ka ajo marrëdhënie me partnerët lokalë, rajonalë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë, a bashkëpunon me njësitë e tjera, a ka mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar.

### **Administrimi i burimeve njerëzore**

Duhet analizuar, politika e kualifikimit dhe e trajtimit të personelit në të gjitha nivelet, akademik ose ndihmës, kompetencat në këtë lëmë, politika e trajtimit social, dhe nëse ka të dhëna, politika e punesimit.

### **Administrimi financiar**

A përgatitet buxheti sipas disa rregullave të caktuara; a janë të mjaftueshme mjetet financiare për realizimin e qëllimeve e objektivave të IAL; a është organizuar politika e kontrollit buxhetor dhe financiar dhe a vepron në përputhje me procedurat e miratuara.

### **Administrimi i sistemeve të informacionit dhe i logjistikës**

A ka njësi sisteme informacioni; teknologjitë e informacionit a janë në përputhje me nivelet e kohës; jeta studentore a është nën kujdesin e njësisë, a njihen pasuritë e patundshme dhe administrohen ato në mënyrë korrekte, a vlerësohet, administrohet e ruhet trashëgimia kulturore dhe shkencore, mjediset dhe logjistika administrative.

Në botimin “**Aspekte dhe Tregues të Vlerësimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë**”, Pjesa e Dytë, botim i AAAL, mars 2005, Agjencia propozon disa tabela, me anë të të cilave njësi sjell tregues sasiore që përfshihen në Raportin e Vetëvlerësimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi sigurohet gjatë vizitës në vend se këto janë të sakta, sjell në raport komente dhe analizë mbi këto tregues duke tërhequr vëmendjen sidomos në ata tregues që dëshmojnë për një shmangje nga standardet kombëtare të AL dhe të tillë që janë tregues të mirëfilltë të cilësisë së një aspekti të caktuar që shqyrtohet.

### **II.4.4. Përfundime**

Në fund të Raportit, GVJ duhet të përmbledhë gjithçka është gjetur e mbajtur qendrim, në formën e një analize SWOT (**S**trength-**W**eaknesses-**O**pportunities-**T**hreats). Kjo nënkupton që në fund të fundit GVJ duhet të nxjerrë në pah nga i gjithë vlerësimi i kryer se cilat janë Pikat e Forta të njësisë apo programit, diplomës që vlerësohet (Strength), cilat janë pikat e dobëta (Weaknesses), cilat janë mundësitë dhe kapacitetet mbi të cilat mbështet njësi për ndryshimin dhe përmirësimin e gjendjes (Opportunities) dhe a ka dhe cilët janë faktorët që kërcënojnë ndryshimin e gjendjes drejt përmirësimit (Threats).

## II.4.5. Rekomandime

Pasi GVJ bën këtë lloj analize, duke i sjellë të katër aspektet në formë pikash të dukshme, të qarta e pa ekuivoke, e mbyll raportin me **Rekomandimet**. Në këtë pjesë të raportit, GVJ, bazuar në të katër pikat e mësipërme, rekomandon se çfarë masash duhet të ndërmerret njësia, stafi, drejtuesit më të lartë, organet politikëbërëse dhe aktorët e tjerë që kanë të bëjnë me çështjet, për të siguruar përputhjen me standardet dhe përmirësimin e cilësisë. Në këtë pjesë të raportit duhet të dalë qartë se kujt i drejtohen rekomandimet për veprim të mëtejshëm.

Pasi Raporti i Vlerësimit të Jashtëm përgatitet, GVJ e diskuton atë përfundimisht në një mbledhje të tij, studjon përputhshmërinë e tij me kërkesat e përfshira në këtë udhëzues dhe e miraton me konsensus. Raporti në këtë fazë është një raport paraprak, sepse ai më pas, duhet të paraqitet në pikat më kryesore të tij në një takim që GVJ organizon me njësinë në vlerësim, GVB dhe titullarin e institucionit. GVJ duhet të marrë parasysh gjatë këtij takimi sugjerimet, komentet apo propozimet për ndonjë ndryshim në raport, kur këto janë të argumentuara. Vetëm pas këtij takimi, GVJ harton formën përfundimtare të raportit, i cili në dy kopje dhe i firmosur nga të gjithë antarët e grupit, dorëzohet në Agjencinë e Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Baza për vendosjen e marrëdhënieve midis aktorëve në procesin e vlerësimit dhe akreditimit është

transparenca, besimi reciprok, bashkëpunimi dhe ndihma.

Vlerësimi i Jashtëm përbën një instrument përmes të cilit AAAL ushtron përgjegjësinë që ka për të siguruar që institucionet e arsimit të lartë ofrojnë një arsim cilësor dhe në përputhje me standardet. Ai, duke raportuar për të njëjtin objekt që raporton edhe Raporti i Vetëvlerësimit, ndihmon për një njohje më objektive të gjendjes së arsimit të lartë. Ai ndihmon përfituesit e arsimit duke u ofruar atyre informacion mbi gjendjen e tij.

Marrëdhënia e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm me AAAL bazohet në kontratën e hartuar midis dy palëve në të cilën shprehet angazhimi i GVJ për të paraqitur një raport objektiv, të paanshëm dhe transparent për të gjitha gjetjet që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimit kundrejt financimit përkatës dhe të gjithë mbështetjes tjetër të AAAL. Në thelb këto marrëdhënie bazohen në shërbimin që AAAL përcakton në kushtet e paraqitura në kontratë dhe rregullohen me të.

Midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe IAL ekzistojnë marrëdhënie bashkëpunimi. Interesi i GVJ dhe i IAL është që ecuritë e IAL të raportohen në mënyrë sa më të plotë, në mënyrë sa më të paanshme, në mënyrë objektive dhe transparente. Për arritjen e këtij qëllimi IAL i ofron GVJ gjithë ndihmën e nevojshme dhe GVJ mban qëndrime etike në gjithë kontaktet e tij me personelin e IAL. GVJ nuk është grup kontrolli, ai nuk ka për mision të vendosë për fatin e personave të IAL dhe roli i tij si

grup faktmbledhës i përcakton atij që në fillim një rol objektiv dhe etik.

Midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe Grupit të Vlerësimit të Brendshëm nuk ekzistojnë marrëdhënie institucionale. Këto janë dy grupe të pavarura nga njëri tjetri, kanë të njëjtin mision, por ngrihen nga institucione të ndryshme dhe pasqyrojnë edhe interesa të ndryshme. Ngritja e dy grupeve të tilla mundëson rritjen e nivelit të objektivitetit të gjetjeve për cilësinë e proceseve akademike në IAL. Duke qenë kështu nuk ekziston asnjë pengesë që anëtarët e njërit grup të konsultohen me ata të grupit tjetër, sepse bashkëveprimi dhe bashkëpunimi midis dy grupeve të vlerësimit, atij të brendshëm dhe atij të jashtëm, është themelor për të sjellë një situatë reale të njësisë. Të konsideruara bashkarisht, nëpërmjet vetëvlerësimit dhe ekspertizës së jashtme, konsideratat në lidhje me katër elementet e sipërpërmendur (analiza SWOT), do të përbëjnë thelbin e përfundimeve dhe rekomandimeve që do përfshihen më pas edhe në Raportin Përfundimtar të Vlerësimit që hartohet nga AAAL.

### III. MARRËDHËNIET E GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM ME IAL, GRUPIN E VLERËSIMIT TË BRENDSHEM DHE AAAL

Baza për vendosjen e marrëdhënieve midis aktorëve në procesin e vlerësimit dhe akreditimit është transparencë, besimi reciprok, bashkëpunimi dhe ndihma.

Vlerësimi i Jashtëm përbën një instrument përmes të cilit AAAL ushtron përgjegjësinë që ka për të siguruar që institucionet e arsimit të lartë ofrojnë një arsim cilësor dhe në përputhje me standardet. Ai, duke raportuar për të njëjtin objekt që raporton edhe Raporti i Vetëvlerësimit, ndihmon për një njohje më objektive të gjendjes së arsimit të lartë. Ai ndihmon përfituesit e arsimit duke u ofruar atyre informacion mbi gjendjen e tij.

Marrëdhënia e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm me AAAL bazohet në kontratën e hartuar midis dy palëve në të cilën shprehet angazhimi i GVJ për të paraqitur një raport objektiv, të paanshëm dhe transparent për të gjitha gjetjet që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimit kundrejt financimit përkatës dhe të gjithë mbështetjes tjetër të AAAL. Në thelb këto marrëdhënie bazohen në shërbimin që AAAL përcakton në kushtet e paraqitura në kontratë dhe rregullohen me të.

Midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe IAL ekzistojnë marrëdhënie bashkëpunimi. Interesi i GVJ dhe i IAL është që ecuritë e IAL të raportohen në mënyrë sa

më të plotë, në mënyrë sa më të paanshme, në mënyrë objektive dhe transparente. Për arritjen e këtij qëllimi IAL i ofron GVJ gjithë ndihmën e nevojshme dhe GVJ mban qëndrime etike në gjithë kontaktet e tij me personelin e IAL. GVJ nuk është grup kontrolli, ai nuk ka për mision të vendosë për fatin e personave të IAL dhe roli i tij si grup faktmbledhës i përcakton atij që në fillim një rol objektiv dhe etik.

Midis Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe Grupit të Vlerësimit të Brendshëm nuk ekzistojnë marrëdhënie institucionale. Këto janë dy grupe të pavarura nga njëri tjetri, kanë të njëjtin mision, por ngrihen nga institucione të ndryshme dhe pasqyrojnë edhe interesa të ndryshme. Ngritja e dy grupeve të tilla mundëson rritjen e nivelit të objektivitetit të gjetjeve për cilësinë e proceseve akademike në IAL. Duke qenë kështu nuk ekziston asnjë pengesë që anëtarët e njërit grup të konsultohen me ata të grupit tjetër, sepse bashkëveprimi dhe bashkëpunimi midis dy grupeve të vlerësimit, atij të brendshëm dhe atij të jashtëm, është themelor për të sjellë një situatë reale të njësishme. Të konsideruara bashkarisht, nëpërmjet vetëvlerësimit dhe ekspertizës së jashtme, konsideratat në lidhje me katër elementet e sipërpërmendur (analiza SWOT), do të përbëjnë thelbin e përfundimeve dhe rekomandimeve që do përfshihen më pas edhe në Raportin Përfundimtar të Vlerësimit që hartohet nga AAAL.

## IV. RAPORTI PËRFUNDIMTAR VLERËSIMIT

Pas marrjes në dorëzim të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, AAAL harton **Raportin Përfundimtar të Vlerësimit**. Thelbin e këtij raporti e përbëjnë konsideratat në lidhje me katër elementet e sipërpërmendura (analiza SWOT). Ky raport hartohet kryesisht mbi bazën e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm, por aty mund të reflektohen edhe mendimet e mbledhura nga kontaktet e drejtpërdrejta me njësinë. Aty përfshihet eventualisht edhe Plani i Vazhdimësisë së Vlerësimit (PVV), me afate kohore, sipas të cilit AAAL ndjek në vijim njësinë apo programin në fjalë.

Ky raport përfaqëson një sintezë krahasuese të të dy raporteve me theks të posaçëm në evidentimin e katër elementëve përbërës të analizës SWOT të përmendur më sipër:

**Pikat e forta:** kjo pjesë e raportit përshkruan arritjet më pozitive të IAL në drejtim të cilësisë akademike

**Pikat e dobëta:** kjo pjesë e raportit përshkruan pikat më problematike të IAL në drejtim të cilësisë akademike

**Mundësitë:** kjo pjesë e raportit përshkruan mundësitë ekzistuese të IAL, shfrytëzimin më të mirë të tyre me të cilat lidhet rritja e mëtejshme e cilësisë akademike

**Rreziqet:** kjo pjesë e raportit përshkruan rreziqet që i kanosen IAL në drejtim të cilësisë akademike

Një seksion më vete i këtij raporti përbëhet nga gjetjet kontradiktore, kundërshtimet për gjetje ose elementë të tjerë të procesit të vlerësimit dhe propozimet e sugjerimet e mbledhura nga diskutimet që zhvillohen me vetë IAL gjatë gjithë procesit të vlerësimit.

Pjesa e fundit e raportit përfundimtar të vlerësimit përbëhet nga lista e rekomandimeve për IAL dhe për KA, afatet për realizimin e secilit prej rekomandimeve si dhe plani i vlerësimit të realizimit të rekomandimeve të dhëna në Planin e Vazhdimësisë të Vlerësimit (PVV). Ky raport i paraqitet për shqyrtim KA dhe me miratimin e tij merr vlerën institucionale të një dokumenti zyrtar.

## V. AKREDITIMI

Kur vlerësimi kryhet në kuadrin e një procesi periodik vlerësimi dhe akreditimi, Raporti Përfundimtar i Vlerësimit i paraqitet Këshillit të Akreditimit, i cili, mbështetur në të gjitha raportet e vlerësimit dhe dokumentacionin e paraqitur, harton qendrimin e tij dhe rekomandimet e propozimet përkatëse që më pas marrin formën përfundimtare e ekzekutohen nga MASH dhe/ose, sipas rastit, Këshilli i Ministrave. Këshilli i Akreditimit merr gjithashtu vendimin për mënyrën e publikimit të vlerësimit në fjalë. Vendimet, sipas rastit mund të jenë: Akreditohet (PO), Nuk Akreditohet (JO) ose Akreditim me Kusht. Kur merret vendimi i fundit, IAL i lihet një kohë e caktuar për të marrë masat e duhura për ndryshimin e gjendjes, dhe pas kësaj periudhe (që është gjithmonë më e shkurtër se koha e vlefshmërisë së një akreditimi) rivlerësohet për të verifikuar plotësimin e rekomandimeve. Në rast se ato nuk plotësohet në afatin e kërkuar, atëherë merret vendimi negativ.

Në fund të të gjithë procesit të vlerësimit dhe akreditimit, AAAL ka detyrimin që Raportin Përfundimtar të Vlerësimit dhe Rekomandimet e Propozimet e KA t'ja bëjë të njohura IAL që është vlerësuar dhe bën publikimin sipas vendimit të marrë nga KA për atë vlerësim.

Për autorët:

**Prof. As. Dhurata Bozo**, biologe, për rreth 20 vjet pedagoge në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Që prej vitit 2003 është Drejtore e Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë.

**Prof.As. Mimoza Hafizi**, fizikante, është pedagoge në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Ka qënë një nga themelueset e Sistemit të Akreditimit në vendin tonë që nga viti 1999. Që prej shkurtit të vitit 2004 është nënkryetare e Këshillit të Akreditimit.

**Prof. Adem Tamo**, psikolog, është pedagog në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës. Ka përvojë në fushën e Vlerësimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.